

AKT NORMATIV

Nr. 11 datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN 99/2018 “BUXHETIN E VITIT 2019”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 është:

I. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat, gjithsej 127 534 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	82 896	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	38 232	milionë lekë;
- teprica e rezultatit financiar te vitit 2018	2 106	milione leke
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2 310	milionë lekë;
- transferta për bonusin e pensionistëve	1 990	milionë lekë;
Shpenzimet	127 534	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2019, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 844 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	1 446 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 258 milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	140 milionë lekë
Shpenzimet	5 844 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 450 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 618 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Bonusi i pensionistëve në masën 3 000 leke për pensionist, zbatohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare. Pagesat respektive kryhen në muajin dhjetor të vitit 2019 dhe gjatë fillimit të vitit 2020.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

- a) Në paragrafin e parë, zëri “Fondi rezervë” bëhet 2 235 milionë lekë;
- b) Tabela 1 dhe 4 zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

Në nenin 13 paragrafi i parë ndryshohet, si vijon: “Fondi rezervë i buxhetit prej 2 235 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.”

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA